



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04 - 0017377-2/25 dt. 27-03-2025
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 90 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nenin 12 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, dhe pas shqyrtimit të Propozim-Vendimit Nr. 01-020/04-0017377/25, dt. 24.03.2025 të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit AD - HOC për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara në Bujqësi me Rastin e Fatkeqësive Natyrore në Komunën e Mitrovicës së Jugut)

1. **Formohet** Komisioni AD - HOC për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara në Bujqësi me Rastin e Fatkeqësive Natyrore në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
 - 1.1. Hysnije Mikullovc - Kryetare, (DBZHR);
 - 1.2. Elvira Xhemajli - Anëtare, (DBZHR);
 - 1.3. Mirsada Fejzullahi - Anëtare, (DBZHR).
2. Detyrë e Komisionit të lartcekur është të bëjë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, si dhe përgatitjen e Raporteve pas Vlerësimit në përputhje me Rregulloren (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.
3. Komisioni obligohet që punën ta kryej sipas kërkesës së Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera i formuar në Nivel të Komunës dhe Drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural kur paraqitet ndonjë situatë e tillë, dhe pas çdo pune të kryer të hartoj Raportin me Shkrim.
4. Pas përfundimit të punëve dhe hartimit të Raportit të Punës, i njëjti Raport i dorëzohet Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve në Rastet e Fatkeqësive Natyrore dhe

M.

Fatkeqësive Tjera në Nivel të Komunës dhe Drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

5. Komisioni bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Rregulloren (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
6. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës


Bedri HAMZA

Shtojcë:

1x1 Propozim-Vendimi Nr. 01-020/04-0017377/25, dt. 24.03.2025.

T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- 1x1 Anëtarëve të komisionit
- 1x1 Arkivit

